


Vaksinimi i korona virusit në qendrën e vaksinimit - nga caktimi i takimit deri te marrja e dozës së dytë të vaksinimit



1. Takimi

Qendra e vaksinimit të rrethit Lahn-Dill është në Lahnau-Waldgirmes. Vaksinimi është i mundur atje vetëm me takim. Takimet mund të bëhen me **telefon në 0611 505 92 888** (Landi Hessen) ose në internet www.impfterminservice.hessen.de. Për banorët e akomodimit të përbashkët vlen: ne do të rezervojmë një takim për ju, për të cilin punonjësit socialë nga Shërbimi i Imigracionit dhe Integritimit do t'ju informojnë. Të gjithë njerëzit e tjerë duhet të bëjnë takimin vet.



2. Regjistrimi në qendrën e vaksinimit

Qendra e vaksinimit mund të arrihet me autobus dhe tren ose me makinë. Me të mbërritur, pika juaj e parë e thirrjes është tavolina e regjistrimit, ku ne do të regjistrojmë të dhënat e juaja dhe do të verifikojmë se nëse keni të drejtën për një vaksinim. Ju lutemi sillni ID-kartelën tuaj (personale), kartën tuaj elektronike të shëndetit, konfirmimin tuaj të takimit dhe kartën tuaj të vaksinimit (nëse e keni). Ju lutemi sigurohuni që të vishni një maskë të përditshme ose një maskë FFP2.



3. Sqarim

Në zonën vijuese të pritjes ju keni mundësinë që në qendrën e vaksinimit të mësoni më shumë rreth vaksinimit të korona virusit. Nëse nuk keni marrë ende fletën e informacionit dhe deklaraten e pëlqimit, këto dyja do t'i merrni kur të vini në takimin tuaj. Ju lutemi lexoni të gjithë informacionin me kujdes dhe plotësoni fushat e kërkuara. Nëse dëshironi, ju e keni mundësinë që të caktoni një takim për t'u konsultuar me një mjek.




4. Vaksinimi

Vaksinimi në vetvete kryhet në një zonë të kontrolluar nga personeli i trajnuar mjekësor. Vaksina injektohet në pjesën e sipërme të krahut, ashtu si vaksinimi kundër gripit. Edhe një sasi e vogël është e mjaftueshme. Vendi i shpimit është mbuluar më pas me një fllaster. Vaksinimi do të shënohet në kartën tuaj të vaksinimit ose në një certifikatë që përmban të gjitha informacionet e nevojshme.



5. Ekzaminimi vijues

Më pas do t'ju kërkohet të qëndroni në një zonë të veçantë pritjeje deri në 30 minuta nën mbikëqyrjen mjekësore. Kjo siguron që në një rast të pamundur që të keni një reaksion alergjik ose siklet, ne mund të reagojmë shpejt. Nëse pritja ka kaluar pa ndërlikime, mund të shkoni në shtëpi.



6. Vaksinimi i dytë

Në mënyrë që vaksinimi i korona virusit të mund të marrë efekt të plotë, kërkohet që të bëhet një vaksinim i dytë. Andaj gjatë marrëveshjes për takim do të merrni dy takime të caktuar për vaksinimi me dallim kohor prej disa javësh larg njëra tjetrës. Takimi i dytë zhvillohet gjithashtu në qendrën e vaksinimit, procedura është e njëjtë me atë të vaksinimit të parë. Ju lutemi sillni me vete: kartën tuaj të identitetit, kartën tuaj elektronike të shëndetit, kartën tuaj të vaksinimit, konfirmimin e takimit dhe certifikatën e vaksinimit nga takimi i parë.